



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 Qershor 2008, , nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, 14 nenit 21 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe nenit 25 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.02.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR
VENDOSJEN E TRAFOSTACIONIT TË RI TË TIPIT SHTYLLË BETONI NË
SLLOVI

Neni 1

Me këtë Vendim i jepet në shfrytëzim për periudhën afatëgjatë prej 16 vite, toka-Pasuri Shoqërore për Kompaninë për Distribuimin dhe Furnizimin me Energji Elektrike (KEDS-it) për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)0.4kV me fuqi 250kVA në hapësirën prej 9m² në kuadër të pjesës së parcelës P-71409077-02490-0 në vendin e quajtur "Oborishta" me sipërfaqe prej 2685m² e evidentuar në Certifikatën e pronësisë Nr.93/2025 ZK-Sllovi, Pasuri Shoqërore e Rrugëve.

Neni 2

Prona e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, respektivisht sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni 10(20)0.4kV me fuqi 250kVA, është me qëllim të zgjerimit dhe përforcimit të Rrjetit Shpërndarës sipas projektit në bazë të Planit Investiv 2024 nga ana e KEDS-it.

Neni 3

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 të këtij propozim-vendimi, është 16 vite, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

Neni 4

Prona e palujtshme e cekur në neni 1 të këtij propozim-vendimi jepet në shfrytëzim me kompensim, llogaritja e kompensimit për sipërfaqe për m² bëhet për tokën e dhënë në shfrytëzim me sipërfaqën prej 9 m² në bazë vjetore 3.50 €.

Neni 5

Menyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshme do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

Neni 6

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm, dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcializimin e sipërfaqës e cila i jepet KEDS-it në shfrytëzim dhe të njëjtën të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 16 vite.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-463/02-573

Lipjan, më 28.02. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

